

RAPORTË JO TEKNIKË

SUBJEKTI "DEVIS"

Administrator : Kristina Leka




Aktiviteti : Shërbim Lavanderie dhe pastrim kimik

Adresa: TIRANE Njësia Bashkiake Nr.8, Rruga Siri Kodra, Magazina nr.10 kati 1

Qershor 2022

PËRMBAJTJA



MONITORIMI MBI NIVELIN E NJOHJES DHE ZBATIMIT TË LIGJIT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NE SHQIPËRI.

- ↳ Ligji Nr.10 431 datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”
- ↳ Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”
- ↳ Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011, “Për lejet e mjedisit” I ndryshuar me ligjin 60/2014, Shtojca I
- ↳ Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
- ↳ VKM Nr. 13, datë 4.01.2013 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”.
- ↳ VKM Nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”
- ↳ VKM Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- ↳ VKM Nr.435, datë 12.09.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.
- ↳ VKM Nr. 419, datë 26.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”.
- ↳ LIGJ Nr. 52/2020 PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Ky aktivitet zhvillohet nga Shoqëria "DEVIS", shpk, e rregjistruar pranë QKB me numer nip-K31420012M, me aktivitet në fushën e pastrimit kimik, "lavanderi".

Shoqëria "DEVIS", shpk e zhvillonë aktivitetin e saj në një godinë mjaftë të mirë për të ofruar këtë shërbim për klienta e saj. Lavanderia ka të punësuar 67 puntore ku të gjithë të janë të siguruar dhe I ofrone atyre kushte mjaftë të mira pune. Pjesa e punonjësve që punojnë në lavanderi janë të pajisur me veshjet përkatëse për proceset të punës, shoferat dhe punonjësit pranë institucioneve të cilat kanë kontrate me ne përseri mbartin veshjet e punës në proceset e kryerjes së aktivitetit.

Shoqëria është e instaluar në një godinë mjaftë të mirë për zhvillimin e këtij aktiviteti, me kushte mjaftë të mira. Objekti është I vendosur në katin e parë ku I gjithë procesi është I instaluar në këtë katë. Në katin e dytë janë zyrat.

Aktiviteti "DEVIS", shpk ka për si qëllim ofrimin e shërbimeve të klienteve në mënyren sa më të mirë dhe korrekte në operimin e zhvillimit të aktivitetit. Shoqëria operon në treg me një gam mjaftë të mirë në fushën e lavaxionit, pajisjet me të cilat kryen si lavatricet, rrula hekurosjë si dhe tharset janë të një teknologjije mjaftë të mirë dhe modrene. Cdo pajisje pune është konform certifikimeve të duhura dhe bashkohore për zhvillimin e procesit të punës.



➤ *Procesi teknologjik*

Procesi I larjes bëhet me anë të sistemit të pompave të instaluara, të cilat sipasë programit inxhinjerik me detergjente përkatës.Çdo gjë është automatike ku nuk preket asnjë solucion me dore gjate procesit të punës.

Procesi I larjes përbëhet nga këto etapa:

- Larja e parë kryhet shkripëzimi dhe heqja e yndyrnave
- Larja e dytë kryhet shkripëzimi dhe meret detergjenti larës
- Larja e trete meret desifektuesi dhe aromatizuesi

Në përfundim kryhen dy procese shplarje me të cilat meret dhe aroma.Pasi kryhet I gjithë procesi I larjese së rrobave, ato kalojnë në procesin e tharjes , ku me pas janë gati në procesin e hekurosjes. Me mbarimin e procesit të tharjes perfundone cikli I tharjes se produkte qe klientat munde te kene sjelle apo dhe shoqerit te cilat kane kontrata me ne (te sjella munde te jene cercafe, batanije, peshqire, mbulesa etj).Ne momentin qe vjen porosia tek ne nga klienta apo spitale ajo cohet ne dhomen e dergesave nga personat pergjegjes ku mbahet shenim cdo porosi e derguarë pasi ajo cohet tek dhoam perkatese me pas kalone ne hapa e tej ku eshte gati ne fillojne proceset e larjes.

Pasi kryhen të gjitha procedurat përkatëse produkti I larë paketohet në qeset perkatëse dhe mbahen ne lavanderi deri sa klienti vjne dhe I mere apo behen dhe dergesat ne baza te porosive.

Cdo procesit në punë mbahet në vëzhgim nga Administratorja e vetme e Shoqërise, ku ajo mbartë dhe menaxhimin me të madhë të punës në këte aktivitet.

Të gjitha pajisjet e punës janë të një teknologjije mjaftë modern punë si ne kursimin e energjis elektrike ashtu dhe ne proceset e punes.Gjate procesit të punës këto pajisje kane nje vibracion mjafte te lete per shkake te teknologjise mjafte te larte te zoterojne.

Në ambiente e lavanderisë janë të kryera të gjitha instalimet hidraulike për furnizimin me ujë të lavanderise. Këto sisteme tubacionesh janë të lidhura me sistemin e tubacioneve te ujrave te ndotura te zones urbane.


Lëndët e para për aktivitetin janë: Rroba te papastra dhe te tjera per proces larje

Produkti përfundimtare: Rrobat te pastra dhe te dezifektuara

Lëndët ndimëse :Detergjentë për larje rrobashë, (detergjente laresë, denzifektive, zbardhues, aromatizues etj)

Energjia elektrike merret nga rrjeti kryesore I shperndarjes se OSHEE GROUP. Kjo energji sherben per venien ne pune te makinerive dhe pajisjeve te cilat sherbejne per kryerjen e proceseve teknologjike te larjese se rrobave.

Furnizimi me uje kryhet nepermjete linjes kryesore te furnizimit me uje te qytetit.Uji perdoret per kryerjen e proceseve te larjes se rrobave dhe kryerjen personale te punonjesve.





PËRSHKRIMI I ZONËS

Qyteti I Tiranës është kryeqendra e qarkut dhe rrethit me të njëtin emër dhe kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë. Tirana ndodhet në qendër të Shqipërisë, rreth 35 km në lindje të Durrësit dhe rreth 40 km në veri-perëndim të Elbasanit, në një luginë të rrethuar nga Mali i Dajtit në lindje, kodrat e Kërrabës dhe Saukut në jug, kodrat e Vaqarrit dhe Yzberishtit në perëndim dhe ato të Kamzës në very.

Qyteti i Tiranës është qyteti më i madh i Shqipërisë dhe qendra më e madhe ekonomike, administrative, politike, industriale, mediale, akademike, sociale dhe kulturore e vendit.

Tirana ndodhet vetëm 17 km larg aeroportit "Nënë Tereza", i vetmi aeroport ndërkombëtar në Shqipëri i njohur dhe me emrin Rinas. Ky aeroport është hyja më e rëndësishme lidhëse ndërmjet Shqipërisë dhe pjesës tjetër të botës. Tirana shtrihet në koordinatat 41.33° veri dhe 19.82° lindje.

Tirana ndodhet 110 metra mbi nivelin e detit. Lartësia mesatare e fushës së Tiranës është 521 m, kurse dy malet më të larta rrëz të cilëve shtrihet janë Mali i Dajtit me 1612 m dhe Mali me Gropa me 1828 m.

Qyteti gjendet rreth 34 kilometra larg detit Adriatik në perëndim. Nga jugu dhe perëndimi rrethohet nga kodra relativisht të ulta, kurse nga ana veriperëndimore Tirana shtrihet mbi një zonë të rrafshët.

Në periferinë veriore kalon lumi i Tiranës. Disa kilometra më tutje nga ana jugore rrjedh lumi i Erzenit. Para reformës administrative të 2014, sipërfaqja e qytetit të Tiranës ishte rreth 31 km², ndërsa sipërfaqja e gjithë rrethit ishte 1288 km² dhe përfshinte katër qendra:

Tiranën, Vorën, Krrabën dhe Kamzën si dhe 150 fshatra. Pas reformës administrative bashkia e Tiranës u zgjerua në 1,110.03 km² ndërkohë që rrethet si njesi administrative u shkrinë. Tirana gjithashtu është pjesë e qarkut të Tiranës që ka një sipërfaqe prej 1,652 km² dhe përfshin pesë bashki : Tiranën, Kamzën, Vorën, Kavajën dhe Rrogozhinën.

Qendrën e Tiranës e përshkon përroi i Lanës i cili në grykëderdhje bashkohet me lumin Ishëm.

1. Klima

Në Tiranë mbizotëron një klimë nëntropikale-mesdhetare me rreshje dimërore dhe me temperatura mesatare vjetore në korrik + 24° Celsius dhe në janar +7° Celsius. Në vit bie 1 189 mm shi.

2. Etimologjia

Ekzistojnë disa hipoteza për prejardhjen e emrit Tiranë:

1. Tiranë mendohet se vjen nga fjala Theranda, e përmendur në burimet e lashta greke dhe latine, që vendasit e quanin Të ranat, meqë fusha ishte formuar si rezultat i materialeve të ngurta që sillnin ujërat nga malet përreth.
2. Tirana vjen nga Tirkan. Tirkan ka qenë një kështjellë në shpat të malit të Dajtit. Akoma ekzistojnë rrënojat e kësaj kështjelle të lashtë që daton në fillimin e shekullit të parë para lindjes së Krishtit, e cila mendohet të ketë qenë kështjella që historiani bizantin Prokop (shek.VI), e quan kështjella e Tirkanit.
3. Tirana vjen nga Greqishtja e Vjetër Tyros (Τύρος) që do të thotë bulmet. Në fushën e Tiranës, bëhej tregtimi i bulmetrave nga barinjët e zonave përreth.
4. Tirana ose Tirônë, siç quhet në dialektin e vendit, e ka origjinën nga mënyra se si thirreshin banorët e këtij vendi. Duke qenë se popullsia e vendosur në këtë territor vinte kryesisht nga malet e zonës përreth atëherë nga vendasit ato quheshin "Të rônë" (të rënë). Edhe sot, në gjuhën e përditshme, për familjet që vijnë nga zonat malore përdoret shprehja "kanë rënë (psh) në Durrës" (apo diku tjetër)

Për herë të parë emri i Tiranës përmendet në vitin 1418 në një dokument të Venedikut.

3. Arkeologjia

Mozaiku i Tiranës është i vetmi monument arkeologjik brenda territorit të qytetit të Tiranës. Në vitin 1972, gjatë punës për ndërtimin e pallateve të bllokut "Partizani" në lagjen nr. 9 të qytetit të Tiranës, u zbuluan rrënojat e një ndërtese antike, njëri nga ambientet e të cilit ishte i shtruar me mozaik. Sipas autorëve, kemi të bëjmë me një qendër fshatare të shekujve të parë pas Krishtit që në fillim të shek. III u zëvendësua me një vilë fshatare (rustica). Salla me mozaik e pajisur dhe me një absidë ishte ambjenti kryesor i saj. Autorët mendojnë edhe që në shek. V-VI vendin e vilës e zuri një bazilikë paleokristiane. Pjesa e gërmuar e monumentit u rrethua dhe u vu në mbrojtje nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK). Gjatë viteve 2003-2004 punimet e sistemimit të rrugëve dhe instalimeve të ndryshme të bllokut "Partizani" zbuluan pranë rrethimit të monumentit pjesë të tjera të kompleksit. Më kryesoret këtu ishin vaskat e fermentimit të mushtit të rrushit, por edhe pjesë të tjera muresh në dy pika të ndryshme. Brenda këtij kompleksi u zbuluan tre stela varresh të periudhës romake. Gërmimet e fundit përforcuan mendimin se kemi të bëjmë me një vilë fshatare, ndërkohë që nuk është gjetur asnjë e dhënë për transformimin në bazilikë paleokristiane të mbështetur nga autorët e gërmimit të parë të viteve '70. Në mënyrë konvencionale, siti arkeologjik është emërtuar dhe njihet me emrin "Mozaiku i Tiranës"

4. Demografia

Tiranës u përmend për herë të parë midis viteve 1372 dhe 1418 në dokumentet veneciane. Gjatë asaj kohe, ajo njihej si një fshat i vogël që përbëhej nga 60 zona të banuara, me rreth 1000 shtëpi dhe 7300 banorë. Marin Barleti (një historian dhe prift shqiptar nga Shkodra), Tiranë e Madhe dhe e Vogël. Në vitin 1583, qyteti kishte 110 zona të banuara me 2900 shtëpi dhe 20,000 banorë. Kur Sylejman Pasha themeloi qytetin në vitin 1614, ndërtimet e para në zonë ishin një xhami, një furrë dhe një hamam. Dy shekuj më vonë, kontrolli i qytetit u fitua nga familja fisnike Familja Toptani e Krujës dhe kishte vetëm 4000 banorë. Është vërejtur se dy lagjet më të vjetra ishin Mujos dhe Pazari, midis Sheshit Skënderbej dhe Rrugës së Elbasanit, në të dyja anët e lumit Lana. Në vitin 1820 popullsia e Tiranës ishte rreth 12.000 banorë. Pas Rënies së komunizmit në Shqipëri në vitin 1990, qyteti kishte rreth 250.000 banorë dhe që atëherë një fluks i madh nga pjesët e tjera të vendit e ka rritur popullsinë në 557,422 sipas censit të 2011, ndërkohë që rritja vazhdon dhe aktualisht.

Sipas Censit të 2011, përbërja fetare e bashkisë së Tiranës ishte 55.7% myslimane, 6.4% ortodokse, 5.4% katolike dhe 3.4% bektashi. Pjesa tjetër prej 29.1%, ishin kryesisht jofetarë (ateistë, agnostikë etj.) apo të padeklaruar.

5. Ekonomia

Tirana është qendra më e rëndësishme industriale në Shqipëri. Për tu përmendur janë industria e lehtë dhe ushqimore si dhe industria ndërtimore, por edhe industria e ndërtimit të makinerive apo ajo e tekstileve dhe e përpunimit të qelqit. Si në të gjithë vendin ashtu edhe kryeqyteti i Shqipërisë ndodhet në një periudhë tranzicioni. Pas rrëzimit të diktaturës komuniste shumë vepra të dikurshme industriale kanë dalë pjesërisht jashtë përdorimit dhe nuk funksionojnë rregullisht. Por ndërkohë po merren masa të shpejta për rimëkëmbjen dhe vënjen sa më të shpejtë në punë të veprave ekzistuese dhe të reja. Shumica e popullsisë janë sot të punësuar në sektorin e tregtisë dhe atë të ndërtimit, në sektorin e shërbimeve publike, atë turistik dhe si punonjës të shtetit.

6. Transporti

Tirana ndodhet rreth 40 km larg portit më të rëndësishëm të vendit, që ndodhet në Durrës. Qysh prej vitit 2000 dy qytetet lidhen me autostradë. Nga Tirana udhëtojnë përditë autobuzë për në qytetet më të rëndësishme të vendit. Tirana ndodhet rreth 40 km larg portit më të rëndësishëm të vendit, që ndodhet në Durrës. Qysh prej vitit 2000 dy qytetet lidhen me autostradë. Nga Tirana udhëtojnë përditë autobuzë për në qytetet më të rëndësishme të vendit. Autobusë të rinj, sipas të gjitha standardeve evropiane dhe me të gjitha kushtet e një shërbimi cilësor urban. Ashtu siç është premtuar, Bashkia e Tiranës fillon ndërhyrjen në mjetet e transportit publik si pjesë e paketës së masave të përmirësimit të shërbimit, hartuar në kuadër të strategjisë së transportit, në të cilën u konsiderua parësore përmirësimi i kushteve të komoditetit dhe të lëvizjes në shërbimin e Transportit Publik. E konsideruar si një revolucion i madh në standartet e transportit të Tiranës, ky rinovim do

të shtrihet në të gjitha linjat urbane të kryeqytetit, me vënie në funksionim të autobusëve të niveleve më të larta bashkëkohore.

Masat E Propozuara Për Mbrojtjen E Mjedisit

Vlersimi aktuali I aktiviteti nuk shprehe nevoje negative per mjedisin. Gjate procesit te punes subjekti nuk ka rrezik per mjedisn apo terrenin perrethe. Aktiviteti zhvillohet ne kushte bashkohore ku cdo process pune eshtekonforme ligjeve ne fuqi.

Vlersimi I impaktit kryhet ne baze te teknologjise qe operone ky aktivitet.

- Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones

Ne karakteristikat fizike nuk perfshihen ndryshime ne topografine e siperfaqes ku zhvillohet aktiviteti. Instalimet jane ekzistuese dhe vete natyra e aktivitetit nuk sjelle ndikime ne mjedise. Ky aktivitet I kryen gjithë aktivitetin e aj brenda nje ndertese ne katin e pare, duke mos ndikuar negativisht ne territorin perrethe.

- Ndikimet negative në habitat

Objekti ndodhet ne zone urbane te Qytetit te Tiranës. Perreth tij nuk kemi presence te florese dhe faunes. Te vetmet peme jane ato dekoruese.

- Shkarkimet në mjedisë

Nga aktiviteti I larjese se rrobave nuk gjenerone plura nga pajisjet dhe makinerite qe zhvillone procesi I punes, si makinerite e larjes, tharjese dhe hekurosjes. Ne kete aktivitet nuk ka asnje process qe shoqerohet me gjenerim plurashe.

- Shkarkime në ujra

Nga aktiviteti I larjese se rrobave nuk gjenerohen ujra me natyre toksike. Ujrat qe gjenerohen nga procesi teknologjit I larjese jane me natyre urbane te cilat nepermjet sistemit te tubacioneve se bashku me ujra qe dalin nga higjeno sanitare shkarkohet ne sistemin e kanalizime te zones.

➤ Gjenerimi I mbetjeve

Mbetjet qe gjenerohen nga ky aktivite jane :

Mbetje me natyre urbane qe dalin nga punonjesit ose
Mbetjet e kutijave te detergjenteve qe cilat vij dhe meren perseri
nga firmat qe bene mbushjen e tyre.

➤ Emertimi I zhurmave

Nisur nga teknologjia qe ky subjekte perdore, zhurmat qe munde te gjenerohen jane mjaft te ulta. Ku
cdo process pune apo makineri eshte I certifikuar sipas standarteve europiane.

Masat E Propozuara Për Mbrojtjen E Mjedisit

➤ Masat teknike :

Për një ecuri sa me të mire të punës parashikohen rekomandime të ndryshme:

- ❖ Kontrollë të plotë të makinerive të procesit të punës
- ❖ Mirembajtje e sistemitte furnizimit me uje të makinerive
- ❖ Pastrim, lysterje riparime brenda zhvillimit të aktivitetit.
- ❖ Mirembajtje e pemeve dekorative.